



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. _____ Prot.
____/____ 2018

Lezhë, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 18.12.2018

Për: OE. KTHELLA SH.P.K. Rreshen Mirdite

Procedura e prokurimit: E hapur me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-90090-10-16-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Rikonstruksion i rruges Mylte njesia administrative Shenkoll

Fondi limit : Fondi limit 33.641.951 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e dyzet e nje mije e nenteqind e pesedhjetë e nje) leke

Burimi i Financimit : buxheti i bashkise Lezhe. Me vendimin nr 112 date 26.09.2018 “ Per miratimin e nje ndryshimi te vkb nr 13 date 29.01.2018 per miratimin e buxhetit te bashkise lezheper vitin 2018dhe PBA-se 2018-2020 eshte miratur financimi i projektit Rikonstruksion i rruge Mylte njesia administrative Shenkoll me vlere te plote financimi 33 .641.951 leke pa tvsh financim i shtrire ne dy vite buxhetore

Vlera e financimit nga Bashkia Lezhe per vitin 2018 do te jete 11 750 000 leke pa tvsh vlera e mbetur do finanohet ne vitin 2019

Afati i perfundimit te punimeve: data e dorezimit te sheshit te punimeve me perfundim ne 12 muaj

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **BE -IS SHPK me nr nipti K71412003A me vlere oferte 29 432 290 (njezet e nente milion e katerqind e tridhjetë e dy mije e dyqind e nentedhjetë) leke pa tvsh**
2. **KEVIN KONSTRUKSION numer nipti K71401004W, me vlere oferte nuk ka dorezuar oferte**

3. KTHELLA SHPK me numer nipti J69303023D , me vlere oferte 32 947 233 (tridhjetë e dy milion e nentëqindë dyzet e shtatë mijë e dyqindë e tridhjetë e tre) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Shoqëria BE-ISshpk

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga BE-IS shpk me nr nipti K71412003A me vlere oferte 29 432 290 leke u konstatua se :

Se Pari :Ne lidhje me plotësimin e kriterit të kërkuar në piken 2.3.3 germa “a” të kriterëve të vecanta kualifikuese “ Shoqëria të këte në stafin drejtues minimumi dy inxhinier ndertimi; 1 (nje) inxhinier gjeodet;; të cilet duhet të figurojnë si drejtues teknik në licënsën e shoqërisë dhe në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt të fundit të kërkuar. **Per secilin duhet të paraqiten:**

- Kontrate individuale të punës
 - Diploma
 - Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e leshuar nga një trup çertifikuese e akredituar në RSH-se
 - Çertifikate për trajnimin si përgjegjës i sigurisë në kantjere i mbështetur në legjislacionin shqiptar për sigurinë në punë. Leshuar nga një organizem certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit në ME në RSH-se.
- Shoqëria BE-IS shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për ing Ndertimi Bujar Islami të shoqëruar me kontratë pune ,diploma, **dhe nuk ka paraqitur Çertifikate për trajnimin si përgjegjës i sigurisë në kantjere i mbështetur në legjislacionin shqiptar për sigurinë në punë .**
- Shoqëria BE-IS shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për ing . Markshaider Hamz Islamaj të shoqëruar me kontratë pune ,diploma, certifikate trajnimi **por diploma e ing Markshaider nuk është ekuivalente me diploma e ing.Gjeodet pasi diploma për profilin markshaider leshohet nga fakulteti I inxhinierisë së Gjeologjisë ndërsa diploma e profilit ing. Gjeodet sic është kërkuar në dokumentet e tenderit leshohet nga Fakulteti I Inxhinierisë së Ndertimit**

KVO vlerëson se kjo kompani nuk plotëson kriterin e kërkuar në piken 2germa a (një inxhinier ndertimi nuk është i pajisur me certifikate trajnimi dhe nuk plotëson kriterin e drejtuesit teknik me profil “ Inxhinier Gjeodet “

Se dyti :Ne lidhje me plotësimin e kriterit të kërkuar në piken 2 germa “b”

- a. Shoqëria, përveç stafit drejtues, duhet të ketë në stafin mbështes edhe minimumi (dy) Inxhinier ndertimi (ku minimalisht njëri të ketë përfunduar edhe master në profil infrastrukture transporti), 4 teknik ndertimi të cilet duhet të figurojnë në listepagesat

e shoqerise per 6 muajit te fundit te kerkuar. **Per secilin duhet te paraqiten:**

- Kontrate individuale te punes
- Diploma dhe per tekniket deshmi e perfundimit te kualifikimit perkates
- Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se

-Shoqeria BE-IS shpk ka paraqitur dokumentacion per ing . Ndertimi (Arsen Sherri, Nertila Kongjoni , Mirgetjan Gjuta) por te pashoqeruar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se sic eshte kerkuar ne kriterin e mesiperm

- Shoqeria BE-IS shpk ka paraqitur dokumentacion te plote per dy teknik ndertimi Petrit Dema dhe Ismet Islamaj ndersa per teknikin Enver Islamaj ka paraqitur kontrate pune dhe deshmi por nuk ka paraqitur deftesen pjekurie

Ne kriterin e mesiperm eshte kerkuar 4 teknike ndertimi. Dhe kjo shoqeri ka paraqitur dokumentacion te plote vetem per dy teknike ndertimi

KVO vlereson se kjo kompani nuk ploteson kriterin e kerkuar ne piken 2germa b (deshmite kualifikimi te sigurimit teknik per dy ing e stafit mbeshtetes dhe nuk ka paraqitur dokumentacion te plote per dy teknike ndertimi ne stafin mbeshtetes)

Se treti : Ne lidhje me plotesimin e kriterit te pikes 2 germa “c”

Punesimi i mjekes prane shoqerise BE-IS eshte ne kundersizim me nenin 90 te Kodit te Punes

Se katerti : Ne lidhje me plotesimin e kriterit te pikes 2 germa “e” Shoqeria te kete punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 10 specialista ndertimi; 5 manovratore; 3 karpentier; 1 hekurthyes;dhe 5 punetore ndertimi Secili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise.

Per secilin duhet te paraqiten:

- Kontrate individule e punes
- Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se
- Libreza e punes

Per manovratoret te paraqitet edhe deshmia e aftesise profesionale per perdoruesit e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke e leshuar nga DPSHTRR dhe leja e drejtimit ku te disponohet kategoria C.

Shoqeria BE-IS shpk ka paraqitur dokumentacion per :

5 (pese) manovratore

3 (tre) karpentier

1 (nje) hekurthyes

Por nuk ka paraqitur asnje lloj dokumentacioni per 10 specialiste ndertimi dhe per 5 punetore ndertimi

I gjithë dokumentacioni tjetër i paraqitur është për punonjes të kualifikuar në profile të ndryshme por që nuk janë kerkuar nga autoriteti ynë kontraktues

KVO vlereson se kjo kompani nuk ploteson kriterin e kerkuar ne piken 2 germa “e” (nuk ka paraqitur asnje lloj dokumentacioni per 10 specialiste ndertimi dhe 5 punetore ndertimi)

Se pesti : Ne lidhje me plotesimin e kriterit te kerkuar ne piken 2.3.5 “Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001-2015 , ISO 14001-2015 , PAS 99: 2012 **per prodhimin** ose kontrate furnizimi e shoqeruar me certifikatat e mesiperme e materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku minimalisht te perfshihen:

- Inerte
- Betone

Shoqeria BE-IS shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 14.06 .2018 (per inerte) me shoqerine Mustafai shpk te shoqeruar me certifikate ISO 9001:2008 . Kete kontrate furnizimi e ka te pashoqeruar me certifikate PAS 99: 2012 dhe ISO 14001-2015

Ne permbushje te kriterit te mesiperme kjo shoqeri ka paraqitur edhe kontrate furnizimi me shoqerine ASAB shpk date 5.07.2017 te shoqeruar me certifikate ISO 9001 :2008 por kjo certifikate nuk eshte e vlefshme daten e hapjes se ofertave pasi vlefshmeria e saj eshte deri me date 15.09.2018 (dt e hapjes se ofertave date 27 .11.2018)

KVO vlereson se kjo shoqeri nuk permbush kriterine mesiperme pasi edhe po ti referohemi certifikatave ISO te dorezuara ne emer te vete BE-IS shpk ky operator eshte i certifikuar per veprimtari te ndryshme dhe jo prodhimi inetresh , beton sic eshte kerkuar ne kete pike te kriterave te vecanta kualifikuese

Se gjashti : komisioni i vleresimit te ofertave megjithe mangesite e konstatuara ne kriteret e vecanta kualifikuese ka konstatuar mangesi edhe ne preventivin e paraqitur nga shoqeria BE-IS konkretisht :

Ne preventivin e dorezuar nga ana shoqeria BE-IS kka paraqitur nje ze punimi te ndryshem nga preventivi i ngarkuar ne SPE nga ana jone dhe konkretisht
Zeri I preventivit i ngarkuar nga autoriteti yne kontraktor eshte :

NR.	nr.an.	EMERTIMI I PUNUMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
		a, PUNIME GERMIMI				
1	3.106/b	Germim dheu me eskavator 0.5 m3, ne kanale me gjeresi >2m, tok zak ,kategoria IV, ne prezence uji ~2m,me shkarkim ne mjet	m ³	288.0		

Preventivi I dorezuar nga ofertuesi BE-IS shpk eshte :

NR.	nr.an.	EMERTIMI I PUNUMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
		a, PUNIME GERMIMI				
1	3.106/ b	Germim dheu me eskavator 0.5 m3, ne kanale me gjeresi >2m, tok zak ,kategoria IV, ne prezence uji ~2m,me shkarkim ne mjet	m ³	2800	320	896 000

Vihet re nje ndryshim i dukshem i sasise se kerkuar nga ana jone dhe sasise 10 fish te dorezuar nga subjekti Be- IS ,kjo gje ne kundersizim me :

-Nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”

-Neni 53 “Shqyrtimi i Ofertave” pika 3, ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”; KVO gjykon se, preventivi i dorëzuar nga operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në Dokumentet e Tenderit. Nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar qartë sasi të të gjithë zërave të punimeve, të cilat në çdo rast nuk duhet të ndryshohen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi., është përgjegjësia juaj që këto elemente të preventivit të ngelen të pandryshueshme. KVO thekson se nuk jemi në kushtet e përcaktuara nga ligji lidhur me gabime aritmetik në ofertë por, kemi të bëjmë me një pargullsi në ofertë pasi, preventivi i paraqitur prej pre jush nuk është saktësisht ai i paraqitur ne DST.

Edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne raste te tilla ka konkluduar me te njejten arsyetim ligjor qe ofertuesi nuk duhet te ndryshoje asnje element te preventivit te publikuar nga autoritetet kontraktore.

Edhe nese do konsiderohej nga KVO si gabim aritmetik referuar nenit 56 perseri oferta eshte e pavlefshme pasi vlefte pas korrigjimit tejkalon limitin prej +/- 2% te fondit limit

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të

ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” vendosi të refuzojë ofertën e BE-IS për mospermbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese

Shoqeria Kevin Konstruksion

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga KEVIN KONSTRUKSION numer nipti K71401004W, me vlere oferte nuk ka dorezuar oferte KVO konstatoi se:

Nuk ka dorezuar oferte ekonomike

Nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni në përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese

Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” vendosi të refuzojë ofertën e Kevin Konstruksion shpk për mospermbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE , KTHELLA sh.p.k , me nr Nipti: J69303023D dhe me vlere 32 947 233 (tridhjetë e dy milion e nentëqindë dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [bashkise Lezhe , sektorit të prokurimeve publike] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlere përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 07.12.2018

Ankesa: ka ose jo: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

**KRYETARI
FRAN FRROKAJ**



Bashkia Lezhë, L. Skenderbeg , Sheshi "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhë, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al , web: www.lezha.gov.al

